

Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijët (Office of Child Support Service, OCSS) e Administratës së Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration, HRA) në NYC

Hapja e një çështjeje me Zyrën e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijët (OCSS) krijon një regjistër të të gjitha pagesave të mbështetjes për fëmijët dhe ofron një ndërmjetës neutral për prindërit. Ka shumë përfitime nga hapja e një çështjeje të mbështetjes financiare për fëmijët, edhe nëse keni tashmë një vendim divorci ose një lloj tjetër marrëveshjeje jashtë programit të mbështetjes financiare për fëmijët.


Përfitimet



Për disa përfitime kërkohet që të përcaktohet atësia/amësia ligjore.

Shërbimet

Të gjithë prindërit, kujdestarët dhe ofruesit e kujdesit që kanë kujdestarinë e fëmijës janë të kualifikueshëm për shërbime të mbështetjes financiare për fëmijët pavarësisht të ardhurave ose statusit të tyre të imigracionit. Stafit i OCSS-së vepron në interes të publikut dhe nuk përfaqëson asnjërin palë në një çështje mbështetjeje financiare për fëmijët. Palët nuk janë të detyruara të marrin shërbimet e një avokati. Përmbledhtazi, në OCSS ofrohet:



Procesi i çështjes

1 Regjistrohuni për shërbime të mbështetjes financiare për fëmijët
Hapni [aplikimin në internet](https://nyc.gov/hra/ocss) në nyc.gov/hra/ocss. Nëse jeni prind kujdestar që aplikon për ose merr ndihmë ekonomike, duhet të përmbushni kërkesat për mbështetje financiare për fëmijët dhe do të referoheni automatikisht për shërbime.



2 Arrini një marrëveshje për mbështetjen financiare për fëmijët ose merrni një urdher në gjykatë

Sapo të përcaktohet atësia/mëmësia, prindërit mund të bashkëpunojnë me stafin e shërbimit të klientit të OCSS-së për të arritur një marrëveshje për mbështetjen financiare për fëmijët duke ndjekur udhëzimet standarde të mbështetjes financiare për fëmijët. Marrëveshja do të paraqitet në gjykatë para seancës dëgjimore. Si alternativë, palët mund të ndjekin procesin tradicional të paraqitjes vetëm në gjykatë, i cili zgjat më shumë.

3 Urdhri i mbështetjes financiare për fëmijët hyn në fuqi dhe pagesat merren dhe disbursohen. Secila palë mund të kërkojë modifikimin e urdhrat.

Pasi lëshimit të një urdhri, shumica e detyrimit monitorohet dhe programi ynë përdor masa detyrimi federal për të siguruar pagesën. Nëse rrethanat ndryshojnë, prindërit mund të takohen me stafin e shërbimit të klientit për të modifikuar urdhrin dhe për ta finalizuar atë në gjykatë ose të ndjekin procesin tradicional gjyqësor për të modifikuar urdhrin.



Nisja e një çështjeje të mbështetjes financiare për fëmijët dhe çfarë ndodh më pas

Një urdhër për mbështetjen financiare për fëmijët përcaktohet në disa mënyra kur njëri prind nuk është më në familje:

- » Prindi kujdestar mund të nisë një çështje të mbështetjes financiare për fëmijët duke aplikuar përmes Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijët (OCSS) dhe/ose duke paraqitur një kërkesë pranë Gjykatës së Çështjeve Familjare.
- » Nëse fëmija është duke marrë ndihmë ekonomike ose Medicaid, prindi kujdestar duhet të ndjekë programin e mbështetjes financiare për fëmijët. Ai do të referohet automatikisht te mbështetja financiare për fëmijët.
- » Nëse fëmija është institucion kujdestarie, kundër të dy prindërve mund të hapet një çështje për mbështetje financiare për fëmijët. Të dy prindërit do të duhet të paraqiten në gjykatë dhe të paguajnë mbështetje financiare për fëmijët.
- » Një prind kujdestar mund t'i paraqesë një vendim divorci OCSS-së dhe pjesa e mbështetjes financiare për fëmijët mund të zbatohet nga OCSS-ja duke paraqitur një paketë ndryshimi të përfituesit të pagesës. Urdhri bëhet i pagueshëm përmes Njesisë së Arkëtimit të Detyrimit të Mbështetjes Financiare (Support Collection Unit, SCU) pa iu drejtuar përsëri gjykatës.
- » Prindërit kujdestarë mund të hapin një çështje mbështetjeje financiare për fëmijët edhe nëse prindi jokujdestar jeton jashtë shtetit të Nju-Jorkut. Kontaktoni Zyrën tuaj [lokale të Shërbimit të Mbështetjes Financiare për Fëmijët të Gjykatës së Çështjeve Familjare](#) për ndihmë. OCSS-ja mund të zbatojë ose të ndihmojë në modifikimin e një urdhri të mbështetjes financiare për fëmijët të dhënë në shumicën e shteteve të SHBA-së dhe [54 shtete të tjera](#). Urdhret e mbështetjes financiare për fëmijët në NYC mund të regjistrohen në juridiksionin ku banon prindi jokujdestar duke kontaktuar (NCP) [Departamentin Juridik të NYC-së](#).




Grafiku më poshtë jep një përmbledhje bazë se si krijohet dhe menaxhohet një çështje mbështetjeje financiare për fëmijët kur ofrohen shërbime të OCSS-së.



Pagesa të mbështetjes financiare për fëmijët

Më poshtë jepet një grafik që tregon shumën që mund të presin prindërit për mbështetje financiare për fëmijët kur prindi jokujdestar bën një pagesë për detyrimin e vet për mbështetje financiare për fëmijët të urdhëruar nga gjykata në shpeshësinë e përcaktuar tek urdhri. Llogaritësi i mbështetjes financiare për fëmijët mund të ndihmojë në dhënien e një vlerësimi të përafërt të shumës sipas urdhrit: <http://bit.ly/CSCalc>.



Mësoni më shumë sot në nyc.gov/hra/ocss ose na dërgoni email në dcse.cseweb@dfa.state.ny.us